



RAPORTI VJETOR MBI GJENDJEN E FILANTROPISË

FAKTE TË SHPEJTA

3.9%

SHKODËR

2.0%

LEZHË

50.0%

TIRANA

2.9%


FIER

4.9%

BERAT

4.9%

VLORË



3.9%

KUKËS

1.0%

DIBËR

1.0%

DURRËS

5.9%

ELBASAN

2.9%

KORÇË

2.0%

GJIROKASTËR

2.9%

JASHTË SHQIPËRISË

11.8%

NËPË SHQIPËRI



102

numri i rasteve të regjistruara



€4.8 million

vlera totale e regjistruar e donacioneve



€1.7

mesatarja e donacionit për qytetar

Shënimet hyrëse

Raporti vjetor mbi gjendjen e filantropisë në Shqipëri 2018 – Fakte të Shpejta do të ketë një pamje të ndryshme këtë vit. Ka disa arsye për këtë. E para dhe më e rëndësishmja është mungesa e të dhënave të mjaftueshme: vëzhgimi ynë në pesë vitet e fundit tregoi se shpeshtësia e raportimit në media (të cilat janë burimi ynë kryesor i informacionit) mbetet relativisht i vogël, ndërsa të dhënat nga burime të drejtpërdrejta - të cilët i përdorim për të verifikuar informacionet - nuk janë gjithmonë të disponueshme dhe të lehta për t'iu qasur. Vëzhgimi i afërt i situatës në Shqipëri gjithashtu tregoi se pamja e filantropisë në vend po ndryshon nga viti në vit, duke vështirësuar sigurimin e një pasqyre të saktë të trendeve, pa patur akses të mëtejshëm në informacione më të hollësishme.

Për këto arsye specifike, Fakte të Shpejta për Shqipërinë në vitin 2018 do të paraqesë një llogaritje më të hollësishme të vitit aktual, të mbështetur me shembuj të numërt të praktikave të mira, ndërsa trendet treguese të të jepen në fund vetëm si ilustrim për ndryshimet e konsiderueshme në donacione. Ne besojmë se vëzhgimi i vazhdueshëm ndër vite do të tregojë tendenca për zhvillimin e filantropisë si dhe tendenca për raportimin e mediave mbi këtë temë.

Metodologjia

Ky raport është përgatitur duke përdorur bazën e të dhënave Giving Balkans i cili mbetet burimi më i besueshëm i të dhënave për dhënien e bamirësisë në rajon. Për shkak të mungesës së të dhënave zyrtare, Catalyst Balkans shfrytëzon mënyra alternative për të grumbulluar të dhëna, kryesisht raporte të mediave dhe burime të tjera të gatshme. Raportet e mediave janë mbledhur duke ndjekur mediat elektronike, të shtypura dhe online në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar në Shqipëri në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2018.

Të dhënat e grumbulluara më pas procesohen në bazën e informacioneve të Giving Balkans. Kjo metodologji ka disa kufizime, duke përfshirë faktin më të rëndësishëm se mediat nuk i regjistrojnë të gjitha rastet e dhënies së bamirësisë. Megjithatë, ne besojmë se hulumtimi ynë siguron një pasqyrë mjaft të besueshme të aspekteve më të rëndësishme të dhënies së bamirësisë, sepse, shifrat, megjithëse nuk janë gjithëpërfshirëse, ofrojnë një vlerë minimale për treguesit përkatës, gjë që lejon që këto të dhëna të përdoren si tregues të nivelit të zhvillimit të dhënies për të mirën shoqërore në Shqipëri. Si përfundim, nën kushtet aktuale, ne besojmë se metodologjia mundëson të kemi një njohuri paraprake lidhur me gjendjen e filantropisë në Shqipëri në vitin 2018.

Pikat kyçe

Niveli i dhënies

Në vitin 2018 janë regjistruar 102 raste unike të dhënies së bamirësisë, përderisa shuma e regjistruar është gati 4.8 milion EUR.

Shpërndarja gjeografike

Më shumë se 50% të të gjitha donacioneve në Shqipëri në vitin 2018 janë dedikuar për subjekte pranuese në rajonin e Tiranës. Elbasan (5.9%), Berat (4.9%) dhe Vlorë (4.9%), por rajonet e mbetura nuk mbeten prapa me më shumë se dy përqind. Sa i përket qyteve dhe qytezave, Tirana – kryeqyteti mban vendin e parë në shpërndarjen gjeografike me 43.4% të rasteve, duke rezultuar me një shpërndarje jo të barabartë në qytetet tjera.

Donatorët

Viti 2018 është shënuar me një seri të investimeve kapitale nga korporatat. Sa i përket numrit të rasteve të regjistruara, sektori korporativ numëron 38.2%, përderisa donacionet individuale dhe dhëniet e masës individuale kanë arritur kulmin me 25.5% dhe 16.7% përkatësisht. Donatorët e “përzier” si kategori janë paraqitur me 7.8% të të gjitha rasteve të donacionit, dhe të tjerët me 11.8%. Nga të gjitha rastet, 9.8% ishin donacione nga diaspora. Ndërkohë, sa i përket vlerave të regjistruara të donacioneve, pjesa më e madhe vjen nga sektori korporativ (55.1%). Individët përbëjnë vetëm 0.5% të vlerës së regjistruar, të ndjekur nga dhëniet e masës individuale të cilat janë jashtëzakonisht të ulëta me pjesë prej 0.1%.

Fondacionet private

Ndonëse fondacionet private akoma nuk janë shumë aktive, këtë vit janë shënuar me një donacion të konsiderueshëm nga një fondacion privat nga diaspora - 44.2% e shumës totale të regjistruar ishte dhënë për mbështetjen e një programi bursash për studentët shqipëtar jashtë vendit. Ky donacion, duke pasur parasysh madhësinë e tij, në mënyrë të konsidersueshme ndikoi në pamjen e përgjithshme të filantropisë në vitin 2018, veçanërisht në përqindjen e investimeve varësisht nga lloji i donatorit, temës dhe pranuesit.

Temat

Katër tema kanë paraqitur një përqindje të konsiderueshme të rasteve, ndërsa temat tjera numërojnë më pak se 4% secila. Lehtësimi i varfërisë qëndron në 36.3% të rasteve duke marrë vendin e parë në shpeshësinë e donacioneve, përderisa mbështetja e grupeve të marginalizuara mori 23.5% nga të gjitha rastet e donacionit. Shëndetësia dhe arsimit janë paraqitur me 12.7% secila, duke i bërë katër temat kyçe të arrijnë 85.2% së bashku. Nëse i shohim temat tjera, manaxhimi i emergjencave, dhënia sezonale, kultura dhe arti, mjedisi, zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura publike janë shfaqur me më pak se 5% të të gjitha rasteve secila.

Pranuesit

Në vitin 2018, pranuesit më të shpeshtë të donacioneve kanë qenë individët dhe familjet (49%), institucionet (29.4%), dhe organizatat jo fitimprurëse (15.7%). Rrjedhimisht me një mbështetje të fortë për institucionet edukative dhe shoqërore, mbështetja e shtetit (institucione dhe qeveritë lokale dhe kombëtare së bashku) ka arritur kulmin, duke marrë më shumë se një të tretën nga të gjitha rastet e donacionit (34.3%).

Organizatat jo fitimprurëse

Këtë vit, organizatat jo fitimprurëse përfituan nga 15.7% të rasteve të donacionit. Përkrahësi më i shpeshtë i sektorit jo fitimprurës është sektori korporativ, me më shumë se 62% të rasteve të donacionit, përderisa qytetarët (6.3%) dhe individët (25%) treguan më pak interes për këtë lloj pranuesish. Organizatat jo fitimprurëse janë mbështetur për temën e reduktimit të varfërisë në rradhë të parë, me përqindjen më të lartë të rasteve deri tani – 62.5%. Rrjedhimisht, njerëzit me nevoja ekonomike janë përfituesit më të shpeshtë që kanë marrë mbështetje përmes organizatave jo fitimprurëse (75% të rasteve të donacionit të regjistruara).

Përdorim idonacioneve

Mbështetja e një-herëshme është mbizotëruese këtë vit me 71.6% nga të gjitha rastet. Mbështetja afatgjatë është paraqitur me 23.5%, përderisa 4.9% të mbetura janë përdorur për qëllime të panjohura.

Përfituesit


Katër grupet kryesore të përfituesve përfshijnë njerëzit në nevojë ekonomike të cilët kanë tërhequr 37.3% të të gjitha rasteve të donacionit, komunitetet lokale me 23.5%, fëmijët pa përkujdes prindëror me 11.8% dhe njerëzit me probleme shëndetësore me 7.8%. Kategoritë tjera të mbështetura përfshijnë të moshuarit (4.9%), njerëz që jetojnë në shtete tjera (3.9%), njerëz me aftësi të kufizuara (2.9%) dhe të tjerë.

Transparenca e të dhënave

Më shumë se çereku i rasteve (26.5%) kanë treguar vlerën e donacionit, që paraqet një nivel relativisht të ulët të transparencës.

Donatorët

Donacionet varësisht nga lloji i donatorëve



Shembuj të dhënieve nga sektori i korporatave

Iniciativa e ndërtimit ishin lloji mbizotërues i mbështetjes së korporatave. Në një seri investimesh masive gjatë gjithë vitit, Gazësjellësi Trans Adriatik mbështeti ndërtimin dhe rindërtimin e objekteve të ndryshme të rëndësishme arsimore, kulturore dhe infrastrukturore. Duke investuar rreth 2.5 milion EUR në të gjithë Shqipërinë, korporata ndihmoi në (ri)ndërtimin e disa shkollave në Ura Vajgurore dhe Devoll, një çerdhe dhe një bibliotekë në Berat, një muze në Korçë, si dhe sistemin e ujësjellësit Mbrostar në Fier.

Donacioni i INCOMED LLC është një shembull tjetër i shkëlqyeshëm – distributori farmaceutik mbështeti rinovimin e pjesshëm si dhe ndërtimin e godinave të reja të Qendrës Mjekësore Nënë Tereza me më shumë se EUR 11,300.

Disa kompani si Alfa Bank përqëndruan përpjekjet e tyre në pranues individual, duke ndihmuar një familje të varfër katër anëtarëshe për

blerjen e një shtëpie në muajin prill, në vlerë prej rreth EUR 30,000. Në mënyrë të ngjajshme, duke i parë vështirësitë e një familjeje në Tiranë, pas djegies së shtëpisë së tyre në muajin shkurt, fondacioni një Fundjavë Ndryshe bashkë me tre kompani (Next SH.A, Sela & Dini Construction dhe Casagres AL) bashkuan mundin e tyre për të ndërtuar shtëpinë e tyre të re. Falë kontributit të këtij partneriteti jofitimprurës-korporata, vështirësitë u kurorëzuan me një shtëpi të re në muajin maj. Gjithashtu, nisma e qytetit të Tiranës për sigurimin e strehimit social për 50 familje u shoqërua me donacione në formë të paisjeve shtëpiake nga ana e Globe Company Shqipëri me qëllim që të plotësohen nevojat e përgjithshme.

Si një shembull i mbështetjes së vazhdueshme të përpjekjes së vullnetarizimit të korporatave, Alfa Bank mori rolin udhëheqës duke organizuar “Ditën e punës vullnetare për Bankën” tani më për të dhjetin vit rradhazi.

Një tjetër traditë e vazhdueshme edhe pse shumë më e shkurtër në krahasim, vjen nga një NVM. Life Care Nannys, një kompani nga Tirana që specializohet në shitjen e rrobave për fëmijë, dhuroi ushqim për fëmijët e Shtëpisë për të Mitur në Tiranë – kompania ka donuar paisje për Shtëpinë disa herë që nga muaji gusht i vitit 2017.

Së fundi, gjithashtu mbështetja humanitare shënoi vitin 2018. Si reagim ndaj përmbytjeve në mars të vitit 2018, Big Market donoi 420 paketa dhe 15 tonë ushqim për kafshë për bagëtitë e familjeve të prekura në Shkodër. Poashtu, Universiteti WISDOM donoi ushqim për Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë në maj, përderisa të punësuarit e Fibank realizuan punë vullnetare në Kuzhinën Publike të Kryqit të Kuq në muajin tetor.

Shembuj të dhënies nga masa individuale

Megjithëse përfitues të ndryshëm kanë përfitur nga ndihmat e mbledhura përmes dhënies së qytetarëve në vitin 2018, të shumtat e fushatave në Shqipëri janë përqëndruar tek njerëzit në nevojë ekonomike. Për shembull, Tearti “METROPOL” për tre javë organizoi oferta promovuese në partneritet me Food Bank Shqipëri, ku të gjithë spektatorët që ishin të interesuar në ndjekjen e shfaqjes “Nata e Dymbëdhjetë” u ftuan të dhurojnë ushqim dhe të marrin një zbritje prej 40% në biletë.

Dy projekte humanitare u përqëndruan në periudha më simbolike. Një rast ishte Ramazani, gjatë të cilit u organizua një panair (më 28 prill) nga ana e Shoqatës Edukative-Kulturore Sulejmanie, me qëllim të mbledhjes së parave për fëmijët dhe të rinjtë në nevojë ekonomike. Një panair tjetër, nisma Baske e Tiranës, u organizua në Ditën

Ndërkombëtare të Vullnetarizmit (5 dhjetor) me qëllim të mbledhjes së lojërave dhe rrobave për nxënësit e çerdheve dhe shkollave.

Koncertet dhe ankandet humanitare shënuan pranverën e vitit 2018. Solistët e Teatrit të Operas dhe Baletit mbështetën një koncert bamirësie në 6 Mars në Teatrin “Petro Marko” me qëllim të mbledhjes së fondeve për Anxhelinon dy vjeçar që vuante nga një përkeqësim i shikimit për shkak të kequshqyerjes. Më 11 prill u mbajt një koncert bamirësie në Sheshin Skënderbeu, ku performuan shumë artistë të njohur shqiptarë, me qëllim të mbledhjes së fondeve për fëmijët me sëmundje terminale. Disa ankande artistike u organizuan gjatë muajit Mars - një ku studentët në Gjirokastrë organizuan shitjen pikturave të bëra nga fëmijë nga Qendra për Fëmijë me Autizëm, dhe një tjetër, ku një prezantues televiziv nxorri në ankand një pikturë që e kishte marrë nga një vajzë me Sindromën Daun. Që të dy “drejtuesit e ankandit” i dërguan fondet tek artistët e rij.

Disa fushata me interes u përqëndruan në ndërgjegjësimin dhe gjenerimin e rezultateve njëkohësisht. Themeluesi i Fondacionit Firdeus, Elvis Naçi, inicioi shfaqjen e tij televizive në stacionin News 24 nga muaji prill, me qëllim të transmetimit të aktiviteteve të mbledhjes së fondeve që ndihmojnë fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe familjet e varfëra.

Fondacioni Një Fundjavë Ndryshe jep një shembull të drejtpërdrejtë të një aktori vazhdimisht proaktiv në Shqipëri - një që ka mobilizuar me sukses qytetarët, si dhe mbështetjen e korporatave që kanë kontribuar me fonde dhe materiale. Përkatësisht, gjatë sezonit të emisionit të tij Stop TV që filloi nga shkurti deri në qershor, ndihmoi në blerjen, ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive për më së paku 5 familje.

Rinia në veprim

Është shumë e rëndësishme të theksohet se të rinjtë po bëhen më aktivë në organizimin e aktiviteteve dhe fushatave për të ndihmuar të tjerët. Disa nisma interesante që janë vërejtur janë:

Në një nivel më bazik, të rinjtë në Tiranë organizuan një aktivitet të decentralizuar të mbledhjes së xhaketave me qëllim motivimin e njerëzve për të lënë xhaketa të papërdorura në trungjet e pemëve për të pastrehët - ata e quajtën fushatën “Jepni një xhaketë, ngroh një shpirt!”

Një tjetër shembull unik, jo vetëm në Shqipëri por edhe në rajon vjen nga kryeqyteti - me rastin e Muajit të Grave, marsit, dy vajza të reja mblodhën 200 libra, dhe të njejtat i shpërndanë tek gratë që vuajnë dënimet të përditshme në burgun e Tiranës.

Fondacion privat (diaspora)

Fondacioni Biberaj, i financuar nga familja Biberaj që kanë emigruar në Shtetet e Bashkuara në vitin 1968, ka kontribuar në një thirrje për aplikime për bursa të destinuar për studentët shqiptarë. Në bashëpunim me Fondacionin për Zhvillim Shqipëtar-Amerikan (AADF), Fondacioni Biberaj shënoi 50 vjetorin e emigrimit të familjes – dhe vitin e parë të ekzistencës – ku dedikuan më shumë se 2.2 milion EUR për nxitjen e edukimit të mëtejshëm të rinisë shqipëtare dhe dërgimin e tyre jashtë shtetit. Bursat janë të hapura për profesionistë të rinj shqiptarë që dëshirojnë të studiojnë në drejtime si Administrim Biznesi, Arsim, Mikpritje si dhe në fusha të tjera të ngjashme me ato në Shtetet e Bashkuara.

Kontributi individual


Një nga shembujt më të spikatur të donacioneve individuale në vitin 2018 është fushata e repisit të famshëm Noizy, i cili dhuroi 20,000 euro në muajin maj për trajtimin mjekësor të vajzës dy vjeçare e cila vuante nga djegie të rënda. Duke synuar të krijonte efekte të shumëfishta, ai filloi edhe një fushatë për mbledhjen e fondeve në të njëjtin muaj për të strehuar pesë vajza jetime nga Kukësi, të cilave deputeti vendas Agron Shehaj i dhuroi rrogën e tij. Në një iniciativë tjetër, Xhevahir Sukaj, një futbollist shqipëtar dhuroi mbështetje monetare për Shkollën Vendresh në bashkinë e Beratit, për rindërtimin e shkollës e cila ishte në gjendje shumë të keqe. Falë këtij donacioni, nxënësit tani do të kenë ambiente të reja për të mësuar.

Sidoqoftë, shumica e mbështetjes vjen nga shumë individë të tjerë që kërkojnë të ndihmojnë. Donacionet në formë ushqimesh kanë qenë më të zakonshmet. Dy pako ushqimesh janë dërguar në mënyrë anonime në Shtëpinë për të Moshuar në Tiranë në muajin prill dhe qershor, përderisa Dafina Tafa dhe Razie Çaushtena donuan qumësht dhe ushqim për shtëpitë për të moshuar në komunitetet e tyre lokale. Aty ku nevojitej ndihma profesionale, mjekët kanë ndërhyrë. Dy mjek të pensionuar nga Saranda, të nxitur nga mungesa e mjekëve të rij në qytetet e tyre, ofruan shërbimet e tyre për spitalet në nevojë si pjesë e një iniciative në vazhdim. Sipas raportimeve të mjekëve të tjerë që kanë marrë pjesë më herët, kjo traditë ka vazhduar për gati dhjetë vjet.


Profilët e llojeve më të zakonshme të donatorëve

Sektori i biznesit (% e rasteve)

Top 3 subjektet pranuese



Top 3 temat për dhënie




Top 3 grupet e përfituesve përfundimtar




Publiku i gjere (% e rasteve)

Top 3 subjektet pranuese



Top 3 temat për dhënie




Top 3 grupet e përfituesve përfundimtar




Fondacionet private (% e rasteve)

Top 3 subjektet pranuese




Top 3 temat për dhënie



Top 3 grupet e përfituesve përfundimtar



Temat kyçe




Pikat kyçe

Katër temat kyçe të mbështetura ishin: lehtësime të varfërisë, mbështetja e grupeve të marginalizuara, shëndetësia dhe arsimit. Rastet e donacionit të dedikuara për këto tema shtojnë deri në 85.2% të gjitha rastet e regjistruara, me vërejtjen që lehtësime të varfërisë është tema më e mbështetur. Shëndetësia dhe arsimit janë mbështetur në mënyrë të barabartë.

Vargu i temave tjera që janë mbështetur me përqindje më të vogël të rasteve përfshinte manaxhimin e emergjencave përballë fatkeqësive natyrore(4%) – siç ishin përmbytjet në mars – dhënia sezonale(2.9%), kulturë dhe art (2.9%), mjedisi (2%), zhvillimi ekonomik (1%), investime në infrastrukturën publike (1%) dhe të tjera (1%).

Përdorimi i donacioneve



Shpërndarja e ndihmës ndahet sipas nivelit të mbështetjes strategjike. Këtë vit, mbështetja e njëherëshme, duke përfshirë donacione në formë materiale dhe strehim individual (ndër kategoritë e tjera), përbën shumicën e donacioneve me 71.6%. Mbështetja afatgjate që përbëhet nga pasijet, investimet kapitale dhe donacione për bursa dhe shërbime paraqitet me 23.5%. Së fundi, kategoria në të cilën mbështetja është e panjohur qëndron në nivelin e njejtë prej 4.9%, që do të thotë se përdorimi i saktë i donacionit nuk është bërë i qartë nga asnjë prej palëve. Sa i përket investimeve të sektorit korporativ, në vitin 2018 kompanitë dhe NVM-të morën pjesë me 28.2% në rastet e mbështetjes afatgjate, përderisa pjesëmarrja e vlerës është dukshëm e lartë: 98.8% e vlerës së donuar nga sektori korporativ është dhënë në formë të investimeve strategjike.

Shembuj të mbështetjes afatgjate


Përkundër faktit se mbështetja afatgjate përbën më pak se një çerek të rasteve, donacionet e Fondacionit Biberaj (prëmes bursave) dhe të Gazësjellësit Trans Adriatik (përmes investimeve kapitale) kanë sjellë një ndikim të jashtëzakonshëm strategjik me vlerë pothuajse 4.7 milion EUR. Këto shembuj të filantropisë sollën mbështetje për shqiptarët e zellshëm, globalisht dhe lokalisht, duke lejuar arsimin të lulëzojë brenda dhe përtej kufijve.

Fondacioni ALSAR inaguroi Programin e tij të Granteve të Ekselencës në vitin 2018 me bursa që u siguruan në korrik për 150 student ekselent nëpër Shqipëri. Edicioni i ri i këtij programi u zhvillua në dhjetor të 2017 si një plan strategjik për të investuar edhe më tej në arsim, me tendencën që të vazhdojë edhe në vitet në vijim.

Nisma tjera afatgjate mbajnë domethënie gjithashtu. Përmes fushatës për mbledhjen e fondeve të inicuar nga fondacioni "Ti je një Luledielli" gjatë të cilës shiteshin bluza apostafat të dizajnuara, fondet janë grumbulluar për paisje të ndryshme për spitale dhe qendra shëndetësore që do të përmirësonin trajtimin e fëmijëve me probleme shëndetësore. Blerja e 419 bluzave nga Alfa Banka, kontriboi në fushatën e mbledhjes së fondeve në vlerë prej EUR 9,500.

Donacionet për, dhe në bashkëpunim me agjenci të ndryshme shtetërore ndonjëherë mund të marrin formë unike, por zakonisht Tirana është qyteti ku regjistrohen bashkëpunime të tilla. Në përpjekje për të siguruar kushte më të mira dhe mjedis më të sigurt, në fillim të vitit Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës dhuroi dy makina të reja për heqjen e mbeturinave në po të njëjtën bashki.

Pranuesit



Në vitin 2018, pranuesit më të shpeshtë kanë qenë individët dhe familjet me 49% të të gjitha rasteve. Më pas vijojnë institucionet të cilët kanë pranuar 29.4% të të gjitha rasteve, përderisa organizatat jofitimprurëse janë mbështetur në vetëm 15.7% të të gjitha rasteve të donacionit.

Si pasojë, këto tre subjekte pranuese kyçe marin shumicën dërmuese, përderisa pranuesi i fundit i dukshëm, qeveritë lokale/kombëtare, morën 4.9% të totalit të regjistruar të rasteve të donacionit.

Përfituesit

37.3% njerëz në nevojë ekonomike

23.5% komunitet lokale

11.8% fëmijë pa përkujdesje prindërore
njerëz me probleme

7.8% shëndetësore

tjera


5-10%

-

3-5% të moshuarit, njerëz që jetojnë
në shtete tjera

1-3% persona me aftësi të kufizuara, rinia e
talentuar, popullata e përgjithshme

0-1% gra dhe fëmijë të mbijetuar nga dhuna,
prindër beqarë



Katër grupet kryesore të përfituesve(njerëz në nevojë ekonomike, komunitetet lokale, fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe njerëz me probleme shëndetësore) përbëjnë 80.4% të numrit të përgjithshëm të rasteve të donacionit në 2018. Së bashku me lehtësimin e varfërisë që paraqet temën më të mbështetur, njerëzit në nevojë ekonomike kanë marrë përqindjen më të lartë të rasteve të donacionit – rreth 37%.

Pjesa më e madhe e rasteve të lidhura me njerëzit në nevojë ekonomike ka qenë e drejtuar për strehim individual, përdërisa mbështetja

humanitare dhe sigurimi i furnizimeve mbetet pak më pas me përqindje. Ngjajshëm me këtë, shumica e donacioneve që kanë marrë komunitetet lokale ishin investime kapitale që synonin të sigurojnë infrastrukturë publike dhe të përmirësojnë objektet edukative.

Në Shqipëri fëmijët pa përkujdesje prindërore përherë kanë marrë mbështetje të fortë, më shumë se në shtetet tjera në rajon. Në vitin 2018 ky grup përfituesish përfitoi nga 11.8% e numrit total të rasteve të donacionit.

Grupet tjera përfituese të mbështetura me një përqindje të konsiderueshme të rasteve të donacionit përfshijnë të moshuarit (4.9%), njerëzit që jetojnë në shtete tjera (3.9%), por gjithashtu edhe rinia e talentuar (2.9%), persona me aftësi të kufizuara (2.9%), popullata e përgjithshme (2%), prindërit beqarë (1%), të mbijetuarit e dhunës në familje (1%) dhe të tjerë.

Trendet në llojet e donatorëve

% E rasteve

Lloji i donatorit/viti	2016		2017		2018
Publiku i gjere	28.8%	↘	13.3%	↗	16.7%
Sektori i biznesit	22.5%	↗	40.5%	↘	38.2%
Individët	28.8%	↘	27.2%	↘	25.5%

% E shumës së regjistruar

Lloji i donatorit/viti	2016		2017		2018
Publiku i gjere	6.2%	↗	13.1%	↘	0.1%
Sektori i biznesit	15.8%	↗	38.0%	↗	55.1%
Individët	75.8%	↘	10.2%	↘	0.5%

Përqindja e rasteve të donacioneve që vijnë nga sektori korporativ varion nga vitit në vit, prandaj është e vështirë të mund të përcaktohet një trend: pas pjesëmarrjes intenzive në vitin e kaluar, në vitin 2018 sektori korporativ ka pësuar një rënie të vogël në numrin e rasteve të donacionit.

Nga ana tjetër, që nga viti 2015 qytetarët kanë qenë më pak aktiv me një përqindje të zvogëluar në rastet e donacionin të vitet në vijim, por sërisht në vitin 2018 e përforcuan mbështetjen e tyre për më shumë se 3%. Sa i përket donatorëve individual,interesi i tyre ka vazhduar të zvogëlohet për arsye të ndryshme që nga viti 2016 me rënie të vogla prej rreth 2%.

Nëse e shohim vlerën fondeve të donuara, sektori korporativ ka përforcuar mbështetjen e tij në mënyrë shumë pozitive në disa vitet e fundit. Një rritje e konsiderueshme në dhëniet e sektorit korporativ (55.1% këtë vit) u shënuar nga një seri investimesh shumë të mëdha në projekte të lidhura me infrastrukturën, që përbëjnë më shumë se 98% të vlerës totale që vjen nga sektori korporativ. Pas

marrjes së pjesës jashtëzakonisht të lartë të vlerave të regjistruara në vitin 2016, donatorët individual gradualisht e kanë zvogëluar këtë përqindje gjatë viteve në më pak se 1% e shumës totale të regjistruar në vitin 2018. Nga ana tjetër, rënia e jashtëzakonshme e dhënieve nga qytetarët në vitin 2016 është drejtuar kah rritja në vitin 2017, dhe më pas sërish rënie prej 10% në vitin 2018. Në këtë kohë e ardhmja e këtyre trendeve është e panjohur, pasi sektori korporativ i ka zhvendosur qëllimet e përcaktuara, duke ndikuar në llogaritjen e raportit përfundimtar midis llojeve të donatorëve.

Trendet në temat kyçe (në % të rasteve)

	2016		2017		2018
Lehtësimi i varfërisë/zvogëlimi	21.3%	↘	11.0%	↗	36.3%
Mbështetja e grupeve të marginalizuara	18.8%	↗	36.4%	↘	23.5%
Shëndetësia	20.0%	↘	10.1%	↗	12.7%
Arsimi	5.0%	↘	3.2%	↗	12.7%

Shpërndarja e rasteve të donacionit tek temat kyçe duket krejtësisht ndryshe në krahasim me vitin e kaluar. Pas një rënie në vitin 2017, lehtësimi i varfërisë pësoi një rritje të konsiderueshme prej rreth 25% në numrin e rasteve të donacionit në vitin 2018. Shkaqet e një ndryshimi të tillë janë të panjohura, dhe të dhënat tregojnë se kjo temë është mbështetur ndryshe me kalimin e kohës. Edhe pse varfëria në Shqipëri gati është përgjysmuar në disa dekadat e fundit, krizat globale financiare e bënë rritjen në Shqipëri edhe më të ndjeshme, duke vazhduar me varfërinë si një ndër problemet kryesore në shoqërinë e Shqipërisë. Ndryshe nga viti 2017 kur kjo temë ishte mbështetur më së shumti nga qytetarët, këtë vit sektori korporativ ishte shumë më i interesuar në lehtësimin e varfërisë.

Sa për tema të tjera, mbështetja e grupeve të marginalizuara zë vendin e dytë pas rënies nga 36.4% në 23.5% të rasteve – të cilat më së shumti kanë qenë për fëmijët pa përkujdesje prindërore. Arsimi ka pësuar një ngjitje në rastet e donacionit të pranuar (12.7%), që është një fitim i vlefshëm në filantropinë shqiptare në krahasim me stagnimin në 5% ose më poshtë në dy vitet e fundit; vlen të theksohet se arsimi këtë vit pati nivelin më të lartë të mbështetjes që nga viti 2013. Së fundi, shëndetësia mori përqindjen e njejtë sa arsimi – 12.7%, e cila për këtë temë paraqet poashtu një rritje nga viti i kaluar.

Trendet në subjektet përfituese kryesore (% e rasteve)

	2016		2017		2018
Individët/familjet	53.8%	↓	22.0%	↑	49.0%
Institucionet	35.0%	↑	57.2%	↓	29.4%
Organizatrat jo fitimprurëse	8.8%	↑	16.5%	↔	15.7%
Qeveritë lokale/qendrore	0.0%	↑	3.5%	↑	4.9%

Situata për përfituesit individualë/familjet dhe institucionet ka qenë e paqëndrueshme ndër vite, pa një trend specifik. Institucionet kanë hasur ndryshime në numrin e rasteve të donacionit në vitet e kaluara, së pari duke shprehur një rritje në vitin 2017, dhe pastaj një rënie e konsiderueshme prej 57.2% në vitin 2017 në 29.4% në vitin 2018. Donatorët më shumë zgjedhën mbështetjen e drejtpërdrejtë të përfituesve. Si pasojë, dhe në përputhje me një mbështetje më të fortë për lehtësimin e varfërisë, këtë vit individët dhe familjet patën një rritje të konsiderueshme në interes të donatorëve, pasi 49% të rasteve të donacionit u janë dedikuar atyre, e cila shënohet me një rritje prej 27% nga vitit 2017. Në ndërkohë, shpeshësia e dhënies tek organizatat jo fitimprurëse qëndron në nivelin e njëjtë, përdërisa qeveritë lokale dhe kombëtare kanë patur një përmirësim me 1.4%.

Trendet e grupeve të përfituesve përfundimtar kryesor (% e rasteve)

	2016		2017		2018
Njerëz në nevojë ekonomike	31.3%	↓	13.6%	↑	37.3%
Komunitetet lokale	11.3%	↑	15.6%	↑	23.5%
Fëmijë pa përkujdesje prindërore	12.5%	↑	34.7%	↓	11.8%
Njerëz me probleme shëndetësore	20.0%	↓	8.4%	↔	7.8%

Kur tema e lehtësimit të varfërisë tregohet si temë e mbështetur më shpesh, zakonisht përfshihen njerëzit me nevoja ekonomike. Këtë vit ato janë në 37.3% të të gjitha rasteve të donacionit të regjistruara, e cila është gati 24% më e lartë se në vitin 2017, duke e tejkaluar dobësimin një-vjeçar. Rritja e përqindjes së rasteve të donacionit i ka prekur edhe komunitetet lokale, të cilët kanë pësuar një tjetër rritje të vogël prej gati 8% në vitin 2018, pas një rritje prej 4.3% në vitin 2017. Pas rritjes ekstreme të vitit të kaluar në numrin e rasteve të drejtuara kah fëmijët pa përkujdesje prindërore, në vitin 2018 ky grup i përfutuesve përfundimtar është kthyer në nivelin e vitit 2016. Së fundi, njerëzit me probleme shëndetësore qëndrojnë në nivelin e njejtë (7.8%) si në vitin 2017.

Trendet në përdorimin e donacioneve (% e rasteve)

	2016		2017		2018
Mbështetje e njëherëshme	71.3%	↓	68.5%	↑	71.6%
Mbështetje afatgjate	18.8%	↑	26.0%	↓	23.5%
Të panjohur	10.0%	↓	5.5%	↔	4.9%

Pamja sa i përket përdorimit të donacioneve është e përafërt me atë të krijuar në vitin 2017. Mbështetja e njëherëshme ka regjistruar një rritje të vogël prej 3.1%, përderisa mbështetja që rezulton me efekte afatgjate pësoi një rënie të vogël prej 2.5%, duke treguar një shkëmbim të vogël që ndryshon nga viti në vit. Rastet për të cilat nuk ishte e mundur të identifikohet përdorimi i donacioneve qëndrojnë në një nivel të ngjashëm në vitin 2018 (4.9%) pas rënies prej 10% në vitin 2016 në 5.5% në vitin 2017. Kjo mund të shënohet si një aspekt pozitiv i filantropisë Shqipëtare, pasi reduktimi i përdorimit të panjohur të donacioneve është një rezultat direkt i praktikave më të mira të transparencës nga ana e palëve të përfshira.

Hulumtimi Shqipëria Dhuron 2018 Raporti Vjetor për Gjendjen e Filantropisë – Fakte të Shpejta është pjesë e një nisme më të gjerë për të promovuar dhe nxitur filantropinë një rajonin që përfshin Fondacioni Catalyst. Hulumtimi themelor dhe ky publikim janë krijuar nga Fondacioni Catalyst (Catalyst Balkan) si dhe me mbështetjen bujare të Fondacionit C. S. Mott.

Opinionet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Besimi i Balkanit për Demokraci, Fondi Marshall Gjerman i Shteteve të Bashkuara, ose partnerëve të tij.



Catalyst Balkans
38 Takovska, Beograd

catalystbalkans.org
givingbalkans.org

Përgatitur nga
Tomas Bueno Momčilović
Jelena Bekčić

Redaktuar nga
Aleksandra Vesić
Simy Mathews

Beograd, 2019

Të dhënat e mbledhura nga
Judita Krasniqi

Dizajni
Luka Koković